



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM PARAPRAK

Nr. 83, datë 09.03.2021

PËR

**PROPOZIMIN PËR EMËRIM NË GJYKATËN E LARTË,
NË POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE,
TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.244, DATË 09.07.2020,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 136, 147 dhe 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 85, 86, 97 dhe 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikat 9, 12 dhe 14, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes,

V E N D O S I :

1. Miratimin e renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:
 - 1) Znj. {...};
 - 2) Z. {...};
 - 3) Z. {...}.
2. Propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të kandidatit z. {...}.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit iu njoftohet kandidatëve znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
4. Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR